

Pacolli rindërton dy shtëpi në Mitrovicën veriore



Prishtinë, 5 tetor - Si kryetar i fondacionit që mban emrin e tij, Behgjet Pacolli ka bërë të ditur të premten se planifikon rindërtimin e dy shtëpive të shkatërruara gjatë luftës së vitit 1999 në veri të Mitrovicës, të Hadi Rakotelit dhe Beqir Mernicës. "Kemi vendosur të ndihmojmë në Mitrovicën e Veriut dhe tani e shohim se janë pjekur kushtet për të bërë një gjë të tillë", ka thënë Pacolli në një konferencë për gazetarë. Ai ka theksuar se ky është vetëm njëri nga projektet që "fondacioni po i realizon pikërisht tani jo për të bërë fushatë politike, por pasi që pikërisht tani janë pjekur kushtet për realizimin e tyre". Sipas tij, fondacioni "Behgjet Pacolli" ka ofruar edhe rindërtimin e Katedrës së Fakultetit Filozofik në kuadër të UP-së, rindërtimin e Xhamisë së Llapit, meremetimin e një rruge në Rrafsh të Dukagjinit, hapjen e një kanalizimi katërkilometërshe për një fshat të Pejës, si dhe hapjen e rrugës Marevc - Strezoc. Nga ana tjetër, Rakoteli dhe Mernica kanë thënë se deri tani u janë bërë vetëm oferta për blerje të shtëpive të tyre nga Qeveria serbe, por jo edhe oferta për rindërtimin e tyre nga ana e Qeverisë së Kosovës.

"Fondacioni Behgjet Pacolli" ndërton dy shtëpi në veri të Mitrovicës

Familjet e Hadi Rrakotelit dhe Beqir Mernica nga veriu i Mitrovicës, pas tetë vjetësh, do të kenë mundësi brenda vitit të kthehen në shtëpitë e tyre. Këtë e mundësoi "Fondacioni Behgjet Pacolli", i cili do t'ua ndërtojë shtëpitë këtyre dy familjeve

LEONORA MAKOLLI

Prishtinë, 5 tetor - Biznesmeni i njohur Behgjet Pacolli, të premtën, në emër të fondacionit humanitar që mban emrin e tij "Fondacioni Behgjet Pacolli", ka nënshkruar kontratë me të cilën do t'i ndërtojë dy shtëpi në veriun e Mitrovicës për dy familjet shqiptare, Rrakotelit dhe Mernica. Me këtë ndihmë këto dy familje do të kenë

mundësi të kthehen në shtëpitë e tyre pas tetë vjetësh banimi me qira në pjesën tjetër të qytetit të Mitrovicës. "Fondacioni ynë ka bërë vizitë pothuaj vizitë në tërë territorin e Kosovës për t'i parë nga afër hallet e qytetarëve dhe po ashtu tashmë kemi depërtuar edhe në veri të Mitrovicës, ku do t'i ndërtojmë dy shtëpi, në mënyrë që dy familjet të mund të kthehen në

shtëpitë e tyre", tha Behgjet Pacolli, tek po e firmoste kontratën. Ndërsa familja e Hadi Rrakotelit, që ka 15 anëtarë dhe familja Beqir Mernica, me gjashtë anëtarë, e kanë falënderuar Behgjet Pacollin për ndërtimin e shtëpive. "Jam shumë falënderues për ndihmën që më ka dhënë Behgjet Pacolli, sepse tash e tetë vjet nuk kam mundur të kthehem në shtëpinë time në veri, ndërsa për kaq vite kam banuar me qira me 15 anëtarë", tha Hadi Rrakoteli. Po ashtu, falënderim të madh Pacollit i ka bërë edhe Beqir Mernica, duke thënë se deri më tani askush nuk është interesuar për fatin e tij dhe familjen e tij. Më pas, Behgjet Pacolli ka marrë përgjegjësi që t'ia paguajë qiranë familjes Rrakoteli për tetë vjet, ndërsa edhe ta punësojë të birin e Beqir Mernicës. Pacolli gjithashtu ka përkujtuar punët që fondacioni i tij ka marrë përsipër - ndërtimin e dy kateve të Fakultetit Filozofik, restaurimin e Xhamisë së Llapit, meremetimin e një rruge në Rrafshin e Dukagjinit dhe katër kilometra kanalizim në rrethin e Pejës, ndërkohë ka paralajmëruar nisjen e rrugës Maréc-Strezoc, e cila, siç tha Pacolli, do të përfundojë brenda këtij viti.

